



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Neni 52 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës shpall:

Konkurs

Ngritje (avancim) në detyrë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i divizioni për planifikim dhe projekte të komplekseve memoriale
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët 1
Koeficienti/Paga	9
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	08/07/2022
Afati për aplikim	23/07/2022 - 30/07/2022
Institucioni	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Departamenti	Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve Memoriale
Divizioni	Divizioni për Planifikim dhe Projekte të Komplekseve Memoriale
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00009392
Kodi	RPC0002968

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës



- Pálnifikon veprimet brenda zonave për nevojat e hartimit të Planve Hapsinore dhe Urbane;
- Paraqet nevojën për hartimin dhe përgatit materialin për nevojat e projekteve dhe pranimit të projekteve nga kompanitë që bëjnë hartimin e tyre, paraqet nevojën për ndryshim;
- Në bashkëpunim me divizionin ligjor përgatit propozim vendimet për shpalljen e zonave me interes duke pas parasysh ngritjen e ndonjë kompleksi memorial;
- Siguron që projektet të jenë të kompletuara dhe të ketë përdorim adekuat të tyre;
- Menaxhon dhe mirëmban informata për Divizionin brenda Agjencisë. Asiston menaxhimin në organizimin e brendshëm, ofron shërbime lidhur me administrimin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe ngritjen e komplekseve memoriale në Kosovë;
- Siguron funksionimin normal të projekteve për komplekset memoriale;
- Koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e punëve dhe përcakton nevojat dhe profilin për punësimin e punëtorëve të Divizionit;
- Koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve në kompleksete memoriale;
- Menaxhon ekzekutimin e punëve dhe projekteve në terren, përgatitë dokumentet për pagesa dhe harton raportin e pranimit teknik të punëve.

2. Kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e posaçme për pozitën e lirë

- Nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet punë në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë përvijës në punë
- Nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore të parashikuar nga nënparagrafi 1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende
- Nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit përpara konkurrimit për ngritje në detyrë
- Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale 'shumë mirë' apo 'shkelqyeshem' për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare fakulteti: Arkitekturë ose Ndërtimtari me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.

Kualifikime të posaçme formale: Trajnime

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të gjera e të thella të politikave, legjisllacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon divizioni;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektsh të divizionit/departamentit.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit



- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë do të shpallet më së largu deri më datën 06/08/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen

- Njohurit profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimit universitar;
- Njohurit dhe aftësit e përgjithshme;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të divizionit/departamentit.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Interviste

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen



